



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UJËSJELLËS KANALIZIME TIRANE SH.A.  
DEPARTAMENTI LIGJOR DHE PROKURIMEVE  
DREJTORIA E PROKURIMEVE  
SEKTORI I PROJEKTEVE DHE INVESTIMEVE



Datë 30.12.2022

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROKURIMIT:**

“Studim fizibiliteti për analizën ligjore financiare dhe teknike të riorganizimit të shoqërive aksionare aktuale të Ujësjellës Kanalizimeve të Tiranës, Kamzës dhe Vorës”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): studim i fizibilitetit

Numri i referencës së procedurës/Lotit (eve) **REF-55572-12-30-2022**

**VLERA E FONDIT LIMIT:** 9,800,000 (nëntë milionë e tetëqind mijë) lekë pa TVSH.

**Argumentimi:** Bazuar në Relacionin e projektbuxhetit per vitin 2022. Përlllogaritja e fondit limit është bërë bazuar në testimin e tregut me anë të ofertave.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Ujësjellës Kanalizime Tiranë sh.a ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

## KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3; në vlerën 2% të fondit limit: 196,000 (njëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë) lekë .

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas Shtojcës 8

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

**2.1. Përshatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):  
Sipas kritereve të përgjithshme të pranimit/kualifikimit (shtojca 11)**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

**2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020,2021, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 30 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet konkretisht : 2,940,000(Një milion e tetëqind mijë) leke pa t.v.sh.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

$9,800,000 \times 30\% = 2,940,000$  lekë pa t.v.sh

---

**2.2.2** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore (bilancet) gjatë 2(dy) viteve të fundit, (2020, 2021) të çertifikuar nga organet tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në bilancet e 2020,2021, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në përcaktimin e viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr.1009 date 5.3.2009 “Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar” i ndryshuar.

**2.2.3.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2022, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas ligjit nr.9632 datë 30.10.2006”Për sistemin e taksave vendore”i ndryshuar; **(lidhur me afatet e kryerjes se pagesave te caktuara nga njesite e veteqeverisjes vendore për vitin 2022)**, në të cilën është regjistruar sipas QKB dhe vendimeve të Këshilleve Bashkiake të njësive vendore ku operatorët ushtrojnë aktivitetin.

*(Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.*

**2.2.4.**Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë se ka paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2022 sipas ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të DST-së objekt prokurimi.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

**Shënim:** Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar duhet të dorëzojë pranë AK, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit**, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe

nenit 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe ne ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, ne ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2 d).

## 2.3 Kapaciteti teknik:

### 2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të

ngjashme:

#### 2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

Kontratë të sukseshme të ngjashme me objektin e prokurimit të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerë jo më të vogël se 30% të vlerës së fondit limit që prokurohet, perkatesisht **2,940,000 (dy milionë e nëntëqind e dyzetë mijë) leke pa t.v.sh**

**Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin**

**dëshmitë e mëposhtme:**

1. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga **një ent publik** për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

2. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me **sektorin privat**, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 40 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose në një vlerë jo më të vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

$$9,800,000 \times 30\% = \mathbf{2,940,000}$$

---

### 2.3.2 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar në stafin e shoqërisë së tij:

- Minimumi **1 (një) Eksperti Kryesor/Drejtuës Ekipi** – Diplomë Universitare në nivel Master (inxhinieri ose ekonomi). Të ketë të paktën 10 vjet eksperiencë pune.
- Minimumi **1 (një) Ekspert për Vleresimin Financiar** - Diplomë Universitare në nivel Master në fushat e ngjashme me shërbimet e kërkuara (inxhinieri ose ekonomi). Të ketë të paktën 10 vjet eksperiencë pune.

- c. Minimumi **1 (një) Ekspert për vleresimin dhe dizenjimin operacional dhe organizativ** - Diplomë Universitare në nivel Master (ekonomi). Të ketë të paktën 10 vjet eksperiencë pune.
- d. Minimumi **1 (një) Jurist** – për çështjet juridike , Diplomë Universitare ne nivel Master. Të ketë të paktën 5 vjet eksperiencë pune.

**Shënim:** Operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e punonjësve të mësipërm në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojces 12 te DST.

Operatorët ekonomikë të kualifikuar duhet te dorezojne prane AK, përpara nisjes së afateve të ankimit ,të gjithë dokumentacionin provues (kontratën e punës (e vlefshme), diplomën përkatëse) si dhe CV ku të jetë evidentuar eksperiencia në fushën përkatëse.

**Një ekspert nuk duhet të jetë i angazhuar njëkohësisht në stafin e dy shoqërive që marrin pjesë në këtë procedurë prokurimi.**

**2.3.2.** Një punësim mesatar i të paktën 3(tre) personave, për muajin e fundit të vërtetuar me;

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqerore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për muajin e fundit;
- List pagesat e punonjesve sipas formatit qe kerkohet nga legjislacioni ne fuqi per muajin e fundit.

Për punonjësit e sipercituar operatori ekonomik duhet të paraqesë diplomë, dhe kontratë pune (e vlefshme per të paktën periudhën e parashikuar) si dhe të figurojë muajin e fundit në listpagesat e shoqërisë.

**Shënim:** Për piken 2.3.2 dhe 2.3.3 më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.12.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e punonjësit të mësipërm në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojces 12 te DST.

Operatorët ekonomikë të kualifikuar duhet te dorezojne prane AK, përpara nisjes së afateve të ankimit ,të gjithë dokumentacionin provues (kontratën e punës, diplomën përkatëse) si dhe CV ku të jetë evidentuar eksperiencia në fushën përkatëse.

**Në rastet e bashkimit të konsulentëve, kriteret Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM

nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kërkesa lidhur me punonjësit është vendosur duke pasur parasysh llojin e shërbimit të kërkuar.